



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr. Nr. No. 267 Dt. 30/12/24

KODI I ETIKËS DHE DEONTOLOGJISË FARMACEUTIKE

Prishtinë, 2024

Faqe 1 nga 17

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TE KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 9, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenin 19, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor; Nenin 14, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenin 21, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Statutit të OFK-së nr.134 të datës 04/06/2024, në mbledhjen e rregullt të datës 14/12/2024, miraton këtë :

KODINE ETIKËS DHE DEONTOLOGJISË FARMACEUTIKE



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceutika Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 267 Dt. 30/12/24

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Farmaceutike në tekstin e mëtejshëm: Kodi përcakton parimet, rregullat, standardin e sjelljes profesionale dhe etikën, të cilat anëtarët e Odës së Farmacistëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda) janë të detyruar t'i përmbahen. Dispozitat e këtij kodi kanë për qëllim të ruajë lirinë dhe reputacionin e profesionit mjekësor, të ngritë cilësinë e shërbimeve farmaceutike dhe të forcojë besimin midis farmacistit dhe pacientëve, besimin nderkolegial të farmacistëve si dhe besimin e farmacistëve me profesionitët shëndetësor duke respektuar konceptin e autonomisë dhe të drejtave të pacientit.

Fushëveprimi

Neni 2

Dispozitat e kodit etik janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Odës pa marrë parasysh pozitën e tyre në insitucionet publik, private. Veprimi në kundërshtim me dispozitat e këtij kodi, janë të sanksionuar konform Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor

Termet

Neni 3

Termat e përdorur në Kod, e që kanë një kuptim gjinor, pavarësisht nëse përdoren në gjininë mashkullore apo femërore, përfshijnë gjininë mashkullore dhe femërore në mënyrë të barabartë.

Njohja e e legjislacionit

Neni 4

1. Çdo farmacist duhet të njohë dhe respekton legjislacionin në fushën e shëndetësisë, Statutin dhe aktet tjera normative të Odës.
2. Aplikimi për anëtarësim në OFK, nënkupton deklarimin e tij për njohurinë mbi përmbajtjen e obligimeve etike të anëtarit të Odës.

KAPITULLI II PARIMET THEMELORE

Parimi i ndërgjegjshmërisë

Neni 5

Farmacisti është i detyruar të kryejë veprimtarinë e tij profesionale me ndërgjegje, sipas rregullave të profesionit mjekësor dhe me kujdesin e nevojshëm, në përputhje me parimet e etikës mjekësore dhe deontologjisë dhe parimet e njerëzimit.

Parimi i barazisë

Neni 6

Farmacistiofron kujdesin shëndetësor në mënyrë të barabartë për të gjithë pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, kombësia, feja ose opinioni politik dhe statusi shoqëror, gjuha, kultura, lloji i sëmundjes, paaftësia mendore ose fizike ose tipare të tjera personale, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e njeriut.

Parimi i respektimit të autonomisë dhe të drejtave të pacientëve

Neni 7

Farmacisti është i detyruar të respektojë të drejtat, liritë, autonominë dhe dinjitetin njerëzor të secilit pacient, si dhe të udhëhiqet në punën e tij nga parimet e bamirësisë, shkaktimi i dëmit më të vogël dhe parimet e drejtësisë.

Parimi i ruajtjes së integritetit profesional

Neni 8

1. Farmacisti është i detyruar të ruajë integritetin dhe dinjitetin profesional.
2. Farmacisti është i detyruar të ruajë me të gjitha aftësitë e tij traditën fisnike të profesionit mjekësor, duke ruajtur standarde të larta të punës profesionale dhe sjelljes etike ndaj pacientit dhe të afërmëve të tij, si dhe ndaj shoqërisë.

KAPITULLI III ETIKA MJEKËSORE

Detyrat themelore

Neni 9

Farmacisti me profesionin e tij i përkushtohet shëndetit publik dhe të përgjithshëm të njeriut, duke i'u përmbajtur standardeve të shkencës mjekësore dhe parimeve etike.

Neni 10

1. Farmacisti duhet të jetë i vetëdijshëm për përgatitjen dhe kompetencat profesionale të tij dhe nuk mund t'i tejkalojë ato.
2. Farmacisti, që ushtron profesionin në farmaci duhet të mbajë veshur uniformën këmishën e bardhë mbi të cilën duhet të jetë dukshëm karta identifikuese profesionale e miratuar dhe e shpërndarë nga Oda.
3. Karta identifikuese profesionale duhet të përdoret vetëm nga farmacistët e regjistruar në regjistrin profesional të Odës, të cilët ushtrojnë profesionin në strukturat shtetërore ose private.

Neni 11

1. Farmacisti duhet të jetë i përkushtuar për zhvillimin dhe përparimin e profesionit dhe të kujdeset për edukimin e vazhdueshëm profesional
2. Njohuritë e fituara profesionale duhet t'i përcjell te kolegët dhe profesionistët tjerë shëndetësorë.

Neni 12

1. Farmacisti duhet të rekomandojë vetëm ato procedura apo ato barna/mjete që konsideron të jenë të dobishme për pacientin dhe në përputhje me standardet e shkencës mjekësore, etikës dhe deontologjisë si dhe legjislacion në fuqi.
2. Farmacisti në asnjë mënyrë nuk do të veprojë në atë mënyrë që të promovojë mbipërdorimin e barnave te pacienti
3. Përsa i përket dizpenzimit të artikujve parafarmaceutike, kozmetike, etj, të cilët ndihmojnë në ruajtjen dhe cilësinë e shëndetit, farmacisti duhet të veprojë në përputhje me rolin e tij dhe në interes të shëndetit të qytetarit si dhe në interes të figurës së profesionit të farmacistit duke ruajtur njëherazi edhe karakterin profesional të farmacistit

Neni 13

1. Farmacisti kryen dizpenzim të barnave tek pacienti, në parim, vetëm me recetë mjekësore.
2. Kjo dispozitë e këtij neni nuk do të zbatohet për një pacient me aftësi të kufizuara mendore, nëse nuk ka pëlqimin e kujdestarit ose të përfaqësuesit ligjor.
3. Nëse pacienti është nën moshën 18 vjeçare, dizpenzimi mund të bëhet me pëlqimin e përfaqësuesit të tij ligjor (prindi, prindi adoptues ose kujdestari), përveç në rastet urgjente.

4. Farmacisti është i detyruar ta informojë pacientin për pasojat për shëndetin e tij në rast të refuzimit të trajtimit me barnat e rekomanduara nga farmacisti apo mjeku përgjegjës.

Neni 14

Farmacisti është i detyruar të ofrojë ndihmë mjekësore urgjente, në përputhje me kualifikimin e tij profesional

Neni 15

1. Puna në rast të rrethanave të jashtëzakonshme është një detyrim i veçantë për një anëtarë të odës.
2. Farmacisti duhet të njohë parimet moderne të doktrinës së punës në rrethana të jashtëzakonshme.

Neni 16

Në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve që rrezikojnë drejtpërdrejt jetën e pacientit, Farmacisti është i detyruar të ndërmarrë veprim në drejtim të dhënies së ndihmës mjekësore

Neni 17

Farmacisti duhet t'i respektojë të drejtat e pacientit, kolegëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësorë si dhe rregullat e institucioneve shëndetësore.

Neni 18

Farmacisti duke bashkëpunuar me organet kompetente duhet të zbulojë, të lajmëroj ose me metoda të tjera të pengojë punën e personave që aktivitetin farmaceutik e kryejnë në mënyrë joprofesionale ose në kundërshtim me ligjin.

Neni 19

Farmacistit përveç ushtrimit të profesionit, nuk i ndalohet ushtrimi i ndonjë veprimtarie tjetër, që përputhet me parimet etike të profesionit të tij.

Neni 20

1. Farmacisti në asnjë rast nuk i lejohet të abuzojë me privilegjet që i krijon statusi i tij profesional ndaj të sëmurit, kolegëve për qëllime përfitimi personal dhe profesional.
2. Farmacisti që kryen funksione profesionale duhet të sigurojë transparencën më të lartë për gjithçka, që mund të duket si konflikt interesi.
3. Farmacisti, madje edhe jashtë ushtrimit të detyres duhet shmangur çdo akt që do të zhvlerësonte personalitetin dhe dinjitetin e tij profesional.

4. Në çfarëdo rrethanë qoftë, ai nuk duhet të lejojë që emri i tij të përdoret për qëllime publicitare e fitimprurëse në kundërshtim me parimet e profesionit.

Privatësia dhe konfidencialiteti

Neni 21

1. Farmacisti duhet të ruajë të dhënat personale dhe shëndetësore të pacientit apo subjekteve tjera.
2. Farmacisti është i detyruar të mbajë si fshehtësi profesionale gjithçka që mëson për gjendjen shëndetësore të pacientit.
3. Ai është i detyruar të kujdeset që fshehtësia profesionale të ruhet edhe prej personave të tjerë që punojnë me të.

Neni 22

Fshehtësia profesionale përfshin të gjitha informacionet që ka Farmacisti gjatë kryerjes së profesionit, për pacientin, rrethanat personale, familjare dhe shoqërore, si dhe informacionin lidhur me zbulimin, trajtimin dhe shërimin e sëmundjes.

Farmacisti është i detyruar të mbajë fshehtësinë profesionale për pacientin dhe për anëtarët e familjes së pacientit, edhe pas vdekjes së tij.

Neni 23

1. Farmacisti duhet të mundësojë qasjen në dokumentacionin mjekësor nëse pacienti e kërkon këtë, dhe nuk është në kundërshtim me rregullin e institucionit.
2. Farmacisti nuk duhet të përmendë emrin e pacientit në publik në mënyrë të tillë që të mos rrezikohet privatësia e pacientit.

Neni 24

Zbulimi i fshehtësive profesionale lejohet vetëm me pëlqimin e pacientit dhe nese është në dobi të pacientit dhe familjes së tij ose interesit publik

Neni 25

Zbulimi i një fshehtësie profesionale lejohet gjithashtu në rast se do të rrezikonte jetën dhe shëndetin e njerëzve të tjerë.

Neni 26

1. Të dhënat mbi rezultatet e hulumtimit mund të përdoren në studimet e kërkimit shkencor, por vetëm në një mënyrë që siguron anonimitetin e pacientit dhe dinjitetin e pacientit.
2. Publikimi i të dhënave të pacientit me qëllim të hulumtimit shkencor dhe profesional është i mundur vetëm me pëlqimin e pacientit.

KAPITULLI IV RAPORTET ME PACIENTIN

Neni 27

Farmacisti duhet ta kryej punën e tij në mënyrë profesionale dhe etike, pa e shfrytëzuar pacientin në aspektin emocional, fizik apo material.

Neni 28

1. Farmacisti do të posedojë, dispenzojë apo prezantojë para pacientit vetëm ato produkte për të cilat është i sigurt se i përmbushin kriteret e përcaktuara ligjore.
2. Farmacisti respekton të drejtën e pacientit për të zgjedhur ose ndrruar terapinë e tyre nëse kjo nuk është në kundërshtim me recetën e mjekut apo shkencën.
3. Farmacisti në institucionet e licencuara për veprimtari farmaceutike do të sigurojë që pacienti apo konsumatori nuk do të ketë qasje dhe mundësi të ketë kontakt fizik me barnat të cilat përshkruhen me recetë e që janë të poseduara në barnatore.

Neni 29

Të afërmit e pacientëve apo persona të tjerë mund të jenë të pranishëm gjatë dispenzimit të barnave

Neni 30

1. Farmacisti mund të rekomandojë te kolegët apo institucione të tjera shëndetësore pacientin, nëse rekomandimi bazohet në bindjen profesionale-mjekësore dhe jo në përfitime personale
2. Farmacisti komunikon me kolegët apo profesionistët tjerë shëndetësorë në rastet kur identifikon problem të mundshëm që do të cenonte trajtimin apo kudjesin e sukseshëm të pacientit.

Neni 31

Farmacisti nuk ka të drejtë ta keqpërdorë dokumentacionin e pacientit në favor të vetin.

Neni 32

1. Komunikimi i mirë është thelbësor në marrëdhëniet farmacist – pacient, farmacist – farmacist dhe farmacist me institucionet relevante administrative.
2. Farmacisti duhet t'ia mundësojë pacientit ose përfaqësuesit ligjor të pacientit që të marrë informatat rreth trajtimit të tij
3. Farmacisti duhet të ofron informata rreth trajtimit të propozuar, opsioneve të tjera të trajtimit, rreziqet e mundshme, dhe dobitë në mënyrë që t'ia mundësojë pacientit të bëjë një zgjedhje të duhur dhe të arsyeshme për të
4. Farmacisti i komunikon rreziqet nga dëmet eventuale që pacienti mund të pësojë nga përdorimi i barnave dhe të veprojë në eliminimin dhe paraqitjen e tyre.

Neni 33

Pasaktësit e qëllimita me qëllim përfitimi dhe mospërputhje me konstatimet mjekësore dhe abuzimi në dispenzim dhe lëshimin e dokumenteve mjekësore, përbën objekt ndjekje dhe përballjeje me proceset e gjyqimit disiplinor profesional dhe juridik për farmacistin

Neni 34

Pacienti duhet të informohet për efektin e barit duke u bazuar në fakte të vërteta dhe të verifikuara. Dallimi në opinion në lidhje me trajtimin më të përshtatshëm nuk duhet t'i shpjegohet pacientit në një mënyrë që do të nënkuptonte në mënyrë të pajustificueshme trajtim të gabuar.

Neni 35

Farmacisti është i detyruar të jetë i besueshëm dhe i sinqertë me pacientët e tij, duke parandaluar pritjet joreale të pacientit pas përfundimit të trajtimit.

Neni 36

Nëse nevojat e trajtimit të pacientit i tejkalojnë mundësitë, njohuritë dhe aftësitë e anëtarit të odës, ai duhet të referohet tek një profesionist apo institucion shëndetësor që plotëson kushtet për trajtimin e duhur.

Neni 37

Farmacisti ka të drejtë të refuzojë trajtimin, por ta referojë pacientin te një farmacist apo profesionistë shëndetësor tjetër, nëse ai konsideron se nuk ka përvojë të mjaftueshme profesionale, nuk ka mundësi teknike për trajtim të suksesshëm, nuk ka një marrëdhënie të besimit të plotë të pacientit në punën e tij, apo pacienti refuzon të bashkëpunojë. Refuzimi i trajtimit nuk vlen për rastet urgjente.

Neni 38

Nëse një pacient i cili është i njohur me gjendjen e tij dhe mund të merr vendim të pavarur, por nuk vepron në përputhje me rekomandimet e doktorit dhe vepron në formë e cila mund të dëmtojë shëndetin e tij, Farmacisti mund të refuzojë kujdesin e mëtejshëm për një pacient të tillë, por me kusht që ai të referohet te një koleg tjetër ose institucion tjetër shëndetësor.

Neni 39

Procedura e nenit paraprak zbatohet edhe në rastet kur pacienti sillet në mënyrë të papërshtatshme, fyese ose kërcënon, por kjo përjashtohet vetëm në rastet kur pacienti nuk është në rrezik për jetën, sepse atëherë ai ka nevojë për ndihmë pavarësisht nga sjellja e tij.

Neni 40

1. Përveç shpërblimit të rregullt për punën profesionale, në formën e pagës ose honorarit, një tjetër përfitim material ose ndonjë përfitim tjetër nga puna e tij mjekësore, si dhe kushtëzimi i ofrimit të një shërbimi shëndetësor me një dhuratë e definuar sipas legjislacionit në fuqi është në kundërshtim me këtë Kod.
2. Farmacisti nuk përfshihet në marrëveshje biznesi e cila do t'ia cënonte të drejtën e pacientit për përzgjedhje të trajtimit apo kujdesit shëndetësor.

KAPITULLI V

RAPORTET NDËRKOLEGIALE

Neni 41

1. Farmacisti duhet të sillet ndaj kolegëve të tij me korrektësi e ndershmëri, duke ruajtur e duke mos cënuar dinjitetin e asnjërit, ashtu siç do të dëshironte, që ata të silleshin ndaj tij.
2. Farmacisti nuk i lejohe të shpif ndaj kolegëve të tij, me qëllim që të ulë autoritetin dhe personalitetin e tyre përpara të pacientit dhe publikut, duke i dëmtuar në ushtrimin e profesionit, si dhe në marrëdhëniet dhe besimin e pacientit ndaj tyre apo në cënimin profesional e integritetit personal të tyre.
3. Incimi i procedurës disiplinore për shpifje pezullohet deri në vendosjen e padisë nga ana e gjykatës, në rast se padia nuk është paraqitur brenda 30 dite nga inicimi i procedurës, incimi hudhet.
4. Asnjë mosmarrëveshje midis kolegëve nuk duhet të çojë në polemika publike, ato duhet të zgjidhen vetëm në rrugën e pajtimit, në rast nevojë edhe me ndërmjetësinë e autoriteteve institucionale apo organeve të Odës.

Neni 42

1. Çdo anëtarë i Odës, e ka për detyrë të ruajë dhe respektojë solidaritetin me kolegët, në të mirë të ruajtjes së integritetit profesional dhe në respekt të normave të etikës dhe deontologjisë farmaceutike
2. Në qoftë se një farmacisti i kërkohet një këshillë, ose ndihmë profesionale nga një koleg, ai duhet të jetë i gatshëm t'i japë ato me sinqeritet dhe në përputhje me njohuritë më të mira që zotëron. Është në nderin e çdo farmacisti të marrë në mbrojtje, në qoftë se një koleg është sulmuar dhe vënë nën akuzë në mënyrë të padrejtë.

Neni 43

1. Farmacisti është i detyruar të mos heshtë dhe të mos qëndrojë indiferent përpara gabimeve që mund të bëhen nga bashkëpunëtorët, ose personeli tjetër ndihmës e të cilat

mund të çënojnë trajtimin apo kudjesin e sukseshëm të pacientit.

2. Ai duhet t'i trajtojë ato pa çënuar dinjitetin e asnjërit dhe asnjëherë përpara pacientit, familjarëve, apo personave të tjerë.
3. Farmacisti, për gjithçka që e konsideron të gabuar e në dëm të punës dhe shëndetit të individit, apo publikut, duhet ta diskutojë me autoritetin drejtues të institucionit dhe/ose me organet e Odës.

Neni 44

1. Në rast se Farmacisti vihet në dijeni të një sjellje të padenjë të një kolegu, e cila nuk përputhet me normat e etikës mjekësore farmaceutike, ai e ka për detyrë t'ia vërë në dije këtë vetëm kolegut të tij dhe autoriteteve drejtuese të institucionit ose organeve të Odës.
2. Farmacistit nuk i lejohet të diskutojë për këtë me pacientin, me familjarët, apo me kolegë dhe persona të tjerë.

Neni 45

1. Farmacisti do të mbrojë kolegët e vet, të cilët janë fajësuar në mënyrë të pabazë, sipas parimeve të kolegialitetit.
2. Nëse këto parregullsi nuk korrigjohen, atëherë ai do t'u drejtohet organeve përkatëse në Odë.

Neni 46

1. Mospajtimi në mendime profesionale nuk duhet të çënojë rregullat e sjelljes së mirë.
2. Në rast se kolegët nuk mund t'i korrigjojnë mospajtimet e ndërsjella, atëherë ata mund t'i drejtohen organeve përkatëse të Odës.

Neni 47

1. Farmacisti si profesionist shëndetësor duhet të sigurojë bashkëpunim efektiv me profesionet e lëmive tjera shëndetësore dhe të jetë i gatshëm për marrjen e përgjegjësive për punën e kryer nga ai apo personi nën mbikqyrjen e drejtpërdrejt të tij.
2. Bashkëpunimi me anëtarë të profesioneve të tjera shëndetësore lejohet, nëse fushat e përgjegjësive së farmacistit dhe anëtarit të profesionit tjetër shëndetësor mbahen qartë të ndara nga njëra-tjetra.

Neni 48

Marrëdhëniet midis kolegëve duhet të bazohen në respektin, korrektësinë, ndershmërinë dhe shkëmbimin e përvojave.

Neni 49

Farmacisti paraqetë kolegun e tij pranë organit kompetent të Odës për lëshimet e bëra profesionale, në një mënyrë të përshtatshme që mos ta cenojë dinjitetin e tij.

Neni 50

1. Mosmarrëveshjet e ndërsjella në pikëpamjet profesionale të farmacistëve nuk duhet të shkaktojnë sjellje të përshtatshme dhe të shkelin parimet etike.
2. Në rast se nuk është e mundur të zgjidhen keqkuptimet, mund të kontaktojnë autoritetet kompetente të Odës.

KAPITULLI VI RAPORTET E FARMACISTIT ME ODËN

Neni 51

Anëtarët e Odës kanë të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të barabarta në Odë.

Neni 52

1. Farmacisti është i detyruar t'i përmbushë obligimet që i ka ndaj Odës, të respektojë, të ruajë reputacionin, si dhe të kontribuojë në punën më të suksesshme të Odës.
2. Pakënaqësitë eventuale mbi punën apo vendimarrjen e organeve të Odës dhe shërbimit profesional të Odës adresohen në organet kompetente brenda Odës.

Neni 53

Pavarësisht ku punon farmacisti, si dhe pozicionit hierarkik në institucionel të cilit i përket, Farmacisti është i detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë nga Oda, për t'u paraqitur për një proces gjykimi disiplinor profesional, apo çfarëdo informacioni, a bashkëpunimi që i kërkohet nga Oda.

Neni 54

1. Vendimet e Kuvendit të OFK-së janë obligative për të gjithë anëtarët e odës. Të njëjtat janë përfundimtare në procedurën e brendëshme administrative dhe mund të atakohen vetëm në rrugë gjyqësore.
2. Anëtarët e organeve të Odës, të cilët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre nuk veprojnë në përputhje me aktet normative materiale në fuqi, i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore në organet etike të odës.

KAPITULLI VII

RAPORTET E FARMACISTIT ME PUBLIKUN

Neni 55

1. Farmacisti si anëtarë i një profesioni të priveligjuar dhe fisnik, duhet të punoj dhe veprojë duke u kujdesur në atë mënyrë që të sigurojë besimin e pacientit dhe publikin për profesionin e farmacistit.
2. Farmacisti nuk do të përdorë pozitën e tij profesionale me qëllim të shfrytëzimit të mungesës së njohurive të tjerëve,
3. Farmacisti duhet të jetë i vetëdijshëm për natyrën sociale të profesionit të tij, prandaj masat duhet të mbështeten dhe promovohen për të përmirësuar shëndetin e përgjithshëm të popullatës

Neni 56

Farmacisti nuk mund të përdorë një titull profesional, shkencor apo akademik, që nuk është fituar në përputhje me rregulloret përkatëse ligjore.

Neni 57

Farmacistit nuk i lejohet të kërkojë apo të pranojë dhurata apo financime kompromituese nga kompani apo individë që tregëtojnë barna, pajisje apo materiale të tjera mjekësore, me përjashtim të financimeve me bazë ligjore

Neni 58

Farmacisti, edhe jashtë ushtrimit të profesionit duhet të ruajë të pastër figurën e tij morale, duke shmangur çdo akt që do të zhvlerësonte personalitetin dhe dinjitetin e tij njerëzor e profesional. Në çfarëdo rrethanë qoftë, ai nuk duhet të lejojë që emri i tij të përdoret për qëllime publicitare e fitimprurëse, ai duhet të ruhet nga keqpërdorimi i emrit të tij jashtë të arriturave profesionale.

Neni 59

Në rastet e akuzave publike, Farmacisti ka të drejtë dhe detyrë të mbrojë reputacionin e tij dhe të kolegëve, si dhe ka të drejtë të zbulojë shënime personale që janë vendimtare për një vlerësim objektiv të një rasti kontestues i cili ka qënë subjekt i akuzës publike

KAPITULLI VIII

REKLAMIMI I SHËRBIMEVE FARMACEUTIKE

Neni 60

Reklamimi i shërbimeve farmaceutike, nuk nënkupton reklamimin e produkteve për të cilat veprohet sipas Ligjit për Produktet dhe Paisjet Medicinale.

Neni 61

1. Farmacisti nuk mund të reklamojë në mënyrë të rreme ose mashtruese.
2. Termi i rremë dhe mashtrues nënkupton paraqitje materiale të gabuar të fakteve, mosparaqitje të fakteve të rëndësishme, duke deklaruar fakte që krijojnë një pritje të pajustificuar të rezultateve, apo paraqitjet se shërbimet e reklamuar janë të një cilësie më të mirë se të anëtarëve tjerë të Odës.

Neni 62

1. Farmacisti ndalohet të përdorë prezantimet e pacientëve për të promovuar aktivitetet e tyre, duke bërë publik dokumentacionin mjekësor të pacientëve me qëllim promovimi.
2. Përdorimi i fotografive të pacientit përmes internetit lejohet vetëm me pëlqimin me shkrim të pacientit dhe pa zbuluar identitetin e pacientit.

Neni 63

1. Farmacisti ka të ndaluar reklamimin, publicitetin e çmimeve të barnave në media elektronike, atë të shkruar, vizive, televizive dhe radiofonike për arsye përfitimi.
2. Reklamimi për shërbime profesionale lejohet të bëhet në mënyrë të tillë që t'i shërbejë informacionit të pacientëve pa qënë tundues për shitje. Ai nuk duhet të jetë i adresuar për barnatore të veçanta dhe nuk duhet të bëhet jashtë barnatore.
3. Reklamimi duhet të jetë dinjitoz të mos shpjerë në njollosje të profesionit dhe të mos krijojë urrejtje midis kolegëve dhe barnatoreve.

4. Farmacisti i punësuar duhet të bëjë kujdes, në mënyrë që çdo reklamë, që ndodhet në barnatore të jetë në përputhje me ligjin, etikën profesionale dhe praktikën e mirë të farmacisë.
5. Ndalohet ekzpozimi në barnatore i çdo publiciteti nga klinikat mjekësore si dhe publiciteti i vendosur në të nga farmaci të veçanta.

KAPITULLI IX

TREGUESIT PROFESIONAL PERSONAL

Neni 64

1. Të vetmit tregues që i lejohet farmacistit të paraqesë në dokumentat dhe njoftimet e ndryshme që publikon si dhe në hyrje të barnatorës të tij janë:
 - Emri i institucionit, adresa, numër telefoni dhe orari i punës.
 - Emri dhe mbiemri i farmacistit
 - Thirrja profesionale.
 - Thirrja akademike apo thirrja shkencore nëse farmacisti posedon.
 - Të dhënat tjera që nuk janë në kundërshtim me parimet e këtij kodi.

KAPITULLI X

FARMACISTI DHE KOMUNIKIMI ELEKTRONIK

Neni 65

Kërkesat për informacion profesional (komunikim komercial)

1. Kur Farmacisti ofron informacion profesional përmes internetit, duhet të tregojë vërtetësi, drejtësi dhe dinjitet. Gjatë krijimit të një faqe interneti, Farmacisti duhet të sigurojë që përmbajtja të mos përmbajë informacione joprofesionale, veçanërisht të një natyre mashtruese ose krahasuese
2. Informacioni i mëposhtëm nuk duhet të vendoset në faqet e internetit:
 - 1.1. Krahasimi i aftësive dhe kualifikimeve ndërmjet farmacistëve që ofrojnë shërbime farmaceutike
 - 1.2. Rangimin e kolegëve në faqet e internetit për interesat e tyre komerciale.

KAPITULLI XI

HULUMTIMET BIOMJEKËSORE

Neni 66

Farmacisti, që merr përsipër një punë kërkimore me qëllim hulumtues, parandalues, diagnostikues apo mjekues, ku përfshihen të sëmurë apo vullnetarë, detyrimisht paraqet projektin përpara një komisioni të posaçëm, kompetent e të pavarur, për të vlerësuar për ligjin shkencore, pranueshmërinë etike dhe për ta miratuar.

Neni 67

1. Farmacisti që ndërmerr hulumtime në fushën e biomjekësisë duhet të jetë i arsimuar dhe i trajnuar në pikëpamje shkencore.
2. Në hulumtimet biomjekësore, duhet t'i përmbahet parimeve etike që rrjedhin nga Deklarata e Helsinkit dhe rishikimeve të saj; Praktika e Mirë Klinike; legjislacioni në fuqi, si dhe në përputhje me protokolet e miratuara nga organi kompetent i Odës.
3. Farmacisti që kryen hulumtimin është i detyruar t'i njoftojë personat që janë përfshirë në projektin hulumtues në detaje për qëllimin e punës, përfitimet e pritshme dhe rreziqet e mundshme, dhe të marrë pëlqimin e tyre me shkrim. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të moshës së mitur, paaftësisë ose gjendja e vetëdijes së personit, kërkohet pëlqimi nga përfaqësuesi ose kujdestari i tij / saj ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 68

Përshtatja, kryerja dhe nxitja e metodave të pavërtetuara shkencërisht që ngjallin shpresë të rrejshme te pacientët dhe familjarët e tyre, është i ndaluar dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Kodit etik dhe deontologjisë farmaceutike

KAPITULLI XII KATEGORIZIMI I SHKELJEVE

Neni 69

1. Klasifikimi i shkeljes në të lehtë apo të rëndë bëhet nga Këshilli Etik i Odës së Farmacistëve të Kosovës. Me rastin e klasifikimit të shkeljes, Këshilli Etik vendos me votën për të të paktën 4 nga 5 anëtarët e Këshillit Etik.
2. Me rastin e klasifikimit Këshilli Etik merr për bazë :
 - a. Shkallën e përgjegjësisë etike
 - b. Motivet e shkeljes
 - c. Dëmtimin e vlerës së mbrojtur
 - d. Rrethanat në të cilën është bërë shkelja
 - e. Sjelljen e mëparëshme të shkelësit
 - f. Pranimin e fajit
 - g. Rrethanat profesionale të shkelësit dhe shkeljet e tij pas shkeljes

Neni 70

Rastet e posedimit/dispensimit të barnave me banderolë të kuqe në barnatore komunitare apo narkotike/psikotrop si dhe përritja e shkeljes së lehtë brenda periudhës 12 mujore nga masa e shqiptuar, si dhe gabimeve në dispensim të cilat kanë pas impakt në gjendjen shëndetësore të pacientit klasifikohen si shkelje të randa dhe nuk mund të ndryshohen nga Këshilli Etik pavarësisht nga neni paraprak.

Neni 71

1. Përjashtimit rasteve nga neni paraprak, Këshilli Etik në përputhje me praktikën e Ligjit për Shëndetësi për shqiptimin e masave ndaj institucioneve, ndaj shkelësit për herë të parë të kodit etik shqipton vërejtjen ose qortimin publik së bashku me kërkesen për shmangien nga shkelja brenda afatit të caktuar.
2. Nëse shkelësi nga paragrafi 1 nuk i bindet dhe nuk vepron përball vërejtjes me shkrim, Këshilli Etik mund të shqiptojë masat disiplinore tjera të paraparë nga Ligji për Odat e profesionsitëve shëndetësorë si :
 - a. Arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim

- b. Trajtim i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe veset tjera
- c. Tërheqja e përkohëshme ose e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri
- d. Dënimi me të holla njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) Euro për cdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike

KAPITULLI XIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 72

1. Çdo sjellje joprofesionale në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, përbën objekt për ndjekje dhe gjykim disiplinor profesional bazuar në Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150. dhe në Rregulloren për përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikëqyerjes etike dhe profesionale
2. Këshilli Etik dhe Gjyqi i Nderit janë organe kompetente për sanksionimin në rast të shkeljes së dispozitave të këtij Kodi.përveq nëse është paraparë ndryshe me dispozitat e këtij kodi.

Neni 73

Oda është e detyruar të harmonizojë aktet e përgjithshme me dispozitat e këtij Kodi brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij Kodi.

Neni 74

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohet kodi i miratuar në Kuvend me datë dhe cdo dispozitë nën statutore që është në kundërshtim me këtë kod.

Neni 75

Ky Kod hyn në fuqi nga data 1 Janar 2025

Prishtinë 14/12/2024



Kryetari i OFK-së
Mr.Ph. Kadri Bytyqi